




# ANALIZA E ECURISË SË ÇMIMEVE TE MOLLËS GOLDEN DELICIOUS DHE GRANNY SMITH NË TREGJE TË SHUMICËS NË VEND DHE RAJON PERIUDHA 15 GUSHT – 25 SHTATOR




Burim i çmimeve të Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekës: <http://www.tisup.mps.hr>




Burim i çmimeve të Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekës: <http://www.tisup.mps.hr>




Ecuria e çmimit të mollës Golden Delicious në tregjet e Tiranës, Lushnjës, Prishtinës dhe Rijekës është paraqitur në grafikun I. Çmimi mesatar i mollës GD në tregun e Tiranës dhe Lushnjës për periudhën, vlerësohet respektivisht në 55 lek/kg dhe 36 lek/kg. Ky produkt është shfaqur në të dyja tregjet nga fundi i muajit Gusht. Ashtu sikurse duket dhe nga grafiku, kemi luhatje të vogla çmimi në të dyja tregjet dhe nuk mund të flasim për tendencë të çmimit në asnjë nga tregjet. Gjatë gjithë periudhës së vëzhguar çmimi mesatar i mollës GD është më shtrenjtë (55.5%) në Tiranë sesa në Lushnjë. Çmimi i mollës gjatë javës së katërt të Gushtit në Tiranë është luhatur rreth vlerës 53 lek/kg, për të vijuar në 58 lek/kg, 57 lek/kg, 50 lek/kg dhe 58 lek/kg në javët pasardhëse. Çmimi i shumicës së mollës GD në tregun e Lushnjës është luhatur rreth katër vlerave: 46 lek/kg, 45 lek/kg, 31 lek/kg, 28 lek/kg dhe 31 lek/kg në javën e tretë të Shtatorit. Një fakt interesant është se në javën e tretë të Shtatorit kemi një rritje të lehtë të çmimit në të dyja tregjet, kjo sepse gjatë kësaj jave si Tirana dhe Lushnja janë furnizuar me mollë GD nga Korça, e cila ka çmim më të shtrenjtë se molla e Lushnjës duke qenë dhe me cilësori se ajo. Çmimi në tregun e Prishtinës është luhatur rreth vlerës 60 lek/kg ose 74 % më i lartë se mesatarja në tregun e Lushnjës. Çmimi në tregun e Rijekës është luhatur rreth vlerës 142 lek/kg ose 3 herë mbi çmimin mesatar në Lushnjë. Grafiku 2 tregon çmimin maksimal FOB Lushnje që mund të negociohet në Rijeka-Kroaci dhe Kosovë- Prishtinë. Çmimi maksimal FOB arrihet duke hequr nga çmimi i shumicës, kostot e transportit, zhdoganimit dhe tarifën e importit (tarifa e importit në Kosovë për mollën është 0% kurse në Kroaci 15% deri në 14 Shtator e mëpas 15% + 14 E/100kg). Sikurse duket edhe nga grafiku avantazhi konkurrues në tregun e shumicës të Prishtinës është i vogël. Hapësira negociuese përgjatë gjithë periudhës është vetëm 48.1%. Megjithatë ashtu sikurse duket nga grafiku fitimi më i lartë rezultoi gjatë javës së dytë të Shtatorit kur diferenca e çmimit FOB Lushnje me atë të tregut të shumicës rezultoi 106 %. Hapësira negociuese mbetet e madhe në Kroaci edhe pse kostot e transportit dhe zhdoganimit për kg janë të larta. Kështu çmimi FOB Rijeka, Kroaci është mesatarisht 187% më i lartë se çmimi i Lushnjës. Hapësira negociuese rezultoi shumë më e lartë para datës 14 Shtator kur tarifa e importit është vetëm 15%. Grafiku 3 tregon ecurinë e çmimit të shumicës së GD të vendit dhe importit si dhe flukset e importit përgjatë periudhës Janar – Tetor. Përgjatë vitit 2009 diferenca në çmimin mesatar të shumicës rezultoi 121%. Pra molla e importit shitet mesatarisht me dyfishin e çmimit të të njëjtit varietet prodhuar në vend. Disa sugjerime që bazohen në observimin e ecurisë së flukseve të importit, çmimit të importit dhe cilësisë së mollës vendase janë: molla vendase Golden Delicious mund të vazhdojë të zëvendësojë atë të importit edhe më tej duke dalë më herët në Gusht e duke vonuar prurjet e të njëjtit produkt të importit. Ruajtja e mirë mund ta zgjasë prezencën e saj deri në Maj e më tej. Rritja e efikasitetit në prodhim dhe teknikat e mbas vjeljes mund të rrisë prezencën e saj në treg pra, në sezonin e hershëm dhe atë të vonë, duke intensifikuar më tej zëvendësimin e importeve. Molla Golden Delicious ka shanse të mira të gjetjes së tregjeve rajonale, për shkak të avantazheve konkurruese në çmim që ajo gëzon. Ky avantazh lejon hapësirë për sofistikim produkti me teknika marketimi e ruajtje si paketimi e brandimi, që mund të shtojnë shanset e hyrjes në këto tregje. Gjetja e momentit të hyrjes është shumë e rëndësishme sepse mund të ndikojë në rritjen e marzhit të fitimit ose në zvogëlimin e tij. Për këtë arsye duhet të zgjidhet me kujdes duke marrë parasysh ndër të tjera edhe tarifën e importit si dhe luhatshmërinë e çmimeve në tregjet përkatëse.



Burim i çmimeve të Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekës: <http://www.tisup.mps.hr>



Burim i çmimeve të Prishtinës: [www.food-ks.org](http://www.food-ks.org) Rijekës: <http://www.tisup.mps.hr>



Grafiku 4 tregon ecurinë e çmimit mesatar të mollës Granny Smith në 4 tregje shumice në tre vende të rajonit, Shqipëri, Kosovë dhe Kroaci. Ashtu sikurse ndodhte me mollën Golden Delicious, edhe Granny Smith shitet me shtrenjtë në Tiranë sesa në Lushnje. Kjo shpjegohet me faktin se Lushnja ka qenë furnizuesi kryesor i tregut të Tiranës gjatë kësaj periudhe. Çmimi i shumicës së mollës GS është luhatur rreth vlerës mesatare 39 lek/kg dhe 61 lek/kg respektivisht në tregun e Lushnjes dhe Tiranës. Çmimi i mollës në Kosovë është luhatur rreth vlerës 60 lek/kg ndërsa në Rijeka 233 lek/kg gjatë periudhës.

Grafiku 2 tregon çmimin maksimal FOB Lushnje me destinacion Rijeka, që mund të negociohet në Rijeka. Tarifat e transportit dhe importit të mollës Granny Smith janë rreth 25% më të larta sesa po të njëjtat tarifa për Golden Delicious. Kjo ndodh për arsye se çmimi i shumicës së mollës Granny Smith në Rijeka është rreth 90 lek më i lartë se ai i mollës Golden Delicious. Ky është një tipar specifik i këtij tregu që na tregon edhe njëherë rëndësinë e preferencave konsumatore pasi fenomeni nuk përsëritet në tregjet e tjera të observuara (Tiranë, Lushnje, Prishtinë) ku çmimi i mollës Granny Smith është pak a shumë i njëjtë me atë të Golden Delicious.

Sikurse duket nga grafiku 2 molla Granny Smith vendase gëzon avantazh konkurrues në çmim në krahasim me të njëjtin varietet që shitet në tregun shumicës në Rijeka. Hapësira midis çmimit të shumicës në Lushnje dhe atij FOB të negociueshëm për në Rijeka gjatë gjithë periudhës është mesatarisht 340%, pra molla vendase Granny Smith mund të shitet me çmim mbi 3 herë më të lartë në Rijeka. Diferenca në vetvete ngushtohet në fund të periudhës për shkak të uljes së çmimit të këtij varieteti në tregun e shumicës së Rijekës. Ndryshe nga molla Golden Delicious ky varietet gëzon edhe përparësi në nivel tarifash importi ku periudha pa shtimin e tarifës specifike të importit është më e gjatë (prezantimi saj me vlerën 14 Eur/100kg fillon mbas dates 31 Shtator). Në Kosovë avantazhi konkurrues është i vogël përderisa çmimet e mollës në Prishtinë janë vetëm pak më të larta se çmimet e mollës në tregun e Lushnjes.

Grafiku 3 tregon ecurinë e çmimit të shumicës së mollës Granny Smith vendase dhe të importit sikurse dhe flusin e importeve të produktit mollë në përgjithësi. Sikurse duket në grafik, edhe në këtë rast ka diferencë në çmim në varësi të kriterit origjinë, megjithëse kjo është më e vogël se në rastin e varietetit Golden Delicious, vetëm 35%. Linja e fluksit të mollës së importit gjatë vitit tregon se fluksi i importit bie mbas muajit Qershor. Edhe këtu prania e varietetit në muajt kur fluksi i mollës së importit bie është një opsion për të rritur vlerat e shitjeve me këtë varietet. Në krahasim me varietetin tjetër të marrë në shqyrtim, Granny Smith paraqet avantazhe konkurruese më të larta në çmim, porë në perspektivën e hyrjes në tregun kroat. Kjo, jo vetëm për shkak të avantazheve të krijuara nga aplikimi më i vonë i tarifës specifike të importit, por edhe nga çmimi më i leverdisshëm me të cilin ky varietet tregtohet. Hapësira e konsiderueshme e negociimit, krijon mundësi që një pjesë e marzhit të mundshëm të fitimit të përdoret për të sofistikuar ofertën e këtij varieteti, duke e harmonizuar atë me pritshmërinë konsumatore në këtë treg në lidhje me teknikat e mbasvjeljes, brandimit, paketimit, higjienës, apo kërkesave të tjera specifike konsumatore.